

## KUMTESA DHE SHENIME

EQREM ÇABEJ

### PJETËR BUDI DHE GJUHA E TIJ

Pjetër Budi prej Gurit të Bardhë të Matit, të cilin bota shqiptare për të parën herë e përkujton sot pas katër shekujsh që nga viti i lindjes së tij, bën pjesë në një lagje shkrimtarësh, nga të cilët më i pari që dimë është Gjon Buzuku, e ata që vijnë pas Budit janë Frano Bardhi, Pjetër Bogdani, Gjon Nikollë Kazazi e të tjerë. Duke i kundruar këta shkrimtarë në tërësinë e tyre, dhe duke i shikuar nga distanca e kohës, nga gjendja e sotme e kulturës së atdheut tonë, vëmë re se ata përfaqësojnë një lulëzim të shënueshëm të shkrimit të gjuhës e të literaturës së vendit. Fakti që këta nuk janë një e dy, po përbëjnë një varg burrash të pendës, na dëshmon se aty nuk kemi një dukuri kulturore sporadike, po kemi të bëjmë me një lëvizje mendore. Kjo gjë shënon një cak me rëndësi në historinë e popullit shqiptar. Dhe ajo na bën të mendohemi, e të hetojmë se ku i ka gurrat kjo rilindje letrare. Si çdo lëvizje e karakterit mendor, edhe kjo jona e shekullit të XVI. e të XVII. nuk është një pjellë gande e rastit, po i ka arsyet e saj të brendshmet e të jashtmet, arsye politike, sociale e psikologjike të kohës.

Më një anë ishte sundimi i huaj, i cili po rëndonte prej disa brezash; më anë tjetër përhapja sa vende e më shumë e një besimi të ri në dëm të besimit të vjetër të vendit. Nuk ka dyshim se këto e të tjera rrethana të rënda të kohës së tyre lanë vrragë të thellë te këta klerikë shkrimtarë. Ndërkaq është vështirë të thuhet a që ndjenja fetare apo dhimbja e vendit e e gjuhës që mëshoi më fort në shpirt të tyre. Mbase do t'ishte psikologjikisht më e drejtë të kërkohej në këtë mes një ndrydhje shpirtërore e vetme e komplekse, e përbërë prej disa faktorësh së bashku, e që u bë shtysë për ta që të rroknin pendën e të shkruanin libra në gjuhën amtare. Gjon Buzuku rrëfen se iu vu hartimit të Mesharit të tij «në së dashunit së botësë sanë», duke përdorur ai në këte vepër fjalën *botë* me kuptimin e latinishtes *patria*, po mbase me një përmbajtje më të gjerë e më të thellë. Për Pjetër Budin dimë se ka zhvilluar një veprimtari politike e agjitatore të gjallë për t'i shtyrë banorët e malësive tona të Veriut të ngrinin krye kundra pushtuesit të huaj, dhe se vetëm vdekja e tij me mbytje në lumë të Drinit i dha fund kësaj veprimtarie. Bardhi përveç fjalorit të tij latin-shqip harton dhe një libër latinisht për Skënderbeun. Pjetër Bogdani u frymëzua te karakteri i atij personaliteti të fortë që qe i ungji i tij Ndre Bogdani. Rrethanat e jetës së Buzukut nuk i dimë. Po nga mënyra si shqipëron ai vise-vise tekstet biblike, herë

duke rrudhur a hequr, herë duke zgjeruar a shtuar diçka nga vetja, shihet se edhe ai ka kryer nën gunë punën e tij. Për këta njerëz e për kohën në të cilën jetonin, atdhe, gjuhë e besim ishin një trinom i pandarë, ata lëftuan me sa mundën për ruajtjen e këtyre vlerave. Në këtë pamje më të gjerë nuk mund të harrohet në këtë mes dhe veprimtaria e klerikëve shkrimtarë e poetë të Arbëreshvet t'Italisë, që janë dhe ata afërsisht të kësaj kohe, siç janë Lekë Matranga, Gjergj Guzeta, Kolë Brankati, Kolë Filja, Kolë Keta, Jul Variboba e të tjerë. E vështruar kështu në këtë pamje, kjo e para lëvizje letrare që ne dimë, në qenësinë e saj nuk paraqitet e ndryshme nga ajo që lulëzoi në shekullin e kaluar, si në Shqipëri si tek Arbëreshët e Italisë. Fryma në thelb është e njëjta, ndryshimet rrjedhin kryesisht prej distancës së kohës. Ajo që i ndan dy periudhat letrare, ka lidhje me zhvillimin e rrethanave historike dhe të kushteve shoqërore. Ajo që i bashkon i ka rrënjët të thella. Është lidhja me vendin, me popullin e me gjuhën e tij, janë aspiratat që burojnë së andejmi.

Veprimtaria letrare e Budit dhe e të tjerëve autorë veriakë të kohës së tij, e cila na intereson në mënyrë fort këtu, historikisht ka lidhje me masat që pat marrë Kundërreformacioni dhe në Gadishull të Ballkanit. Fillimet e depërimit të Reformacionit edhe në këtë trevë, nga një anë nëpër Slloveni e Kroaci, nga ana tjetër nëpër Transilvani, e kishin shtyrë kurjen e Romës në kundërmasa, për t'i vënë një ledh asaj vale. Në këto masa për ruajtjen dhe forcimin e besimit katolik një vend të radhës së parë zë hartimi i shkrimeve fetare dhe përhapja e tyre. Një shtysë të fortë i dha kësaj lëvizje më anë tjetër çfaqja dhe ngulja e Osmanëve dhe përparimi i islamizmit në këto anë, i cili përfaqësonte një rrezik të ri e të pandërmjemë për viset katolike të krahut perëndimor të Gadishullit. Në këto rrethana mori një hov të ri veprimtaria e misionarëve katolikë; bile u la mënjanë për një kohë dhe antagonizmi i vjetër me kishën ortodokse, i cili në Shqipëri kish vazhduar më parë shekuj me radhë. Në lidhje me zhvillimin e literaturës një rëndësi të veçantë në këtë mes ka kjo, që në rrethanat e reja ku u ndodh, kisha romake e pa të udhës t'i linte shteg më shumë shkrimit të librave kishtarë në gjuhët e vendit, duke u larguar disi me këtë hap nga mënyra e mëparme e veprimit në këtë fushë. Kështu u veprua që më parë në disa vise të katolikëve sllavë të Ballkanit; kështu u veprua dhe në Shqipëri, e aty veçanërisht me shkrimet që shqipëroi Pjetër Budi. Shohim pra se përpjekja e këtyre shkrimtarëve për t'i dhënë klerit të vendit e njëkohësisht dhe shtresave popullore libra feje shkruar në gjuhën shqipe, për rrethanat e veçanta të kohës që ne çekëm këtu, gjeti përkrahje, në ndonjë rasë mbase edhe shtysë, në autoritetet e larta kishtarë.

Këto janë me pak fjalë rrethanat e brendshme dhe të jashtmet, të cilat i dhanë shkas lulëzimit të parë të literaturës tek ne dhe brenda të cilave lindi e u zhvillua kjo literaturë. Vepra letrare e përfaqësonte veprën e saj nuk mund të shkëputet nga vepra njerëzore, nga veprimtaria sociale-politike e tyre. Kështu tri librat e Budit, Doktrina e kërshenë, Pasëqyra e të Rëfyemit dhe Ritualu Romak, bashkë me Spiegimin shqip të meshës romake, kuptohen më drejt në gjenezën e në qëllimin e tyre, po të kemi parasysh që autori i këtyre gjatë jetës jo të gjatë të tij lëftoi konsekuentisht për ngritjen e një kleri të vendit e kundra klerit të huaj në Shqipëri dhe bëri përpjekje të vetëdijshme për një përdorim sa më të gjerë të gjuhës së vendit në funksionet e shërbimeve fetare. Është për të vënë re në këtë mes që titulli shqip i Pasëqyrës të së Rëfyemit, në

ndryshim nga titulli latin, përmban dhe shtesën «për ndimë të gjuhës Arbëneshe», shtesë që shënon qëllimin që ndiqte Budi me këtë vepër. Këtë qëllim të tij autori na e shpreh më çiltas në fillim të parathënies së kësaj vepre: «mirë tue pām zotënia juoj se jashtë këncosh ende sã të tjera letëra, me dorë të shkruome, gjindenë mbë sã vise që dëshmonjënë se sã i madh kã qenë gjithëherë kujdesi e dëshirë zemëresë sime për ndimë të Patriese e të gjuhës sanë, qi u vduorrë, ende po vdãrenë mã të shumënë, veçese për letërë e për të mpsuom». Poku qëllim kish frymëzuar më parë Buzukun dhe shtyu më vonë edhe të tjerët prelatë pas Budit për hartimin e librave të tyre. Kështu Bardhi në parathënien e Fjalorit të tij arsyeton hartimin e kësaj vepre me fjalët «Tue pasunë ditë e përditë. . . kujtuem se me gjith copë Librë keshë me ndimuem mbë nja anë giuhënë tanë, gji po bdaretë, e po bastardhohetë sa mã parë të vë». Edhe Bogdani në një letër dërguar Propaganda Fides në Romë më 1675 vren se «ma anche trovandosi la natione tra Turchi, Greci e Serviani di continuo la lingua va perdendosi»<sup>1</sup>. Ai bën dhe përpjekje për pastrim të gjuhës prej fjalësh së huaja, meqë — si na thotë ai vetë — «Mbë tjetërët anë unë tue vum roe të gjymtët e giuhësë Arbëneshe, e silla për të pakëtë vet të madhe pjesë huan giuhëshit konfinjëtare».

Gjuha e Budit është gegërishtja e një faze më të lashtë, në të cilën ky dialekt sidomos në sistemin fonetik të tij nuk u kish larguar sa sot nga toskërishtja e njëkohësisht dhe nga tipi i përbashkët i gjuhës.

Kështu në vokalizëm gjejmë të ruajtur, ashtu si te Buzuku, *ë-në* e theksuar në fjalën *një*, e cila ndërkaq tek autori ynë na del dhe si *nja* e *nji*; pastaj *ë-në* e pathekse, para— e pastheksore dhe fundore në fjalë si *dërrëjt*, *fëruor* «fruer», *të shëtundenë*, *sónëte*, *pëtëka*, *Ishëmi* «Ishmi», kjo formë në një letër të Budit dërguar Kardinal Gozzadinos më 1621; diftongjet e grupet vokalike *ie ye uo je ui ae oe*, në fjalë si *diell*, *krye*, *mbë të dÿ duort*, *ndjerë* për të sotmen *deri*, *fruiti*, *shinë* e *diellinë* e *voesenë* (po *pa venë rë* e *jo roe*, *ngë* *jo ngae*). Me të tjerët shkrintarë të Veriut e me ligjërimet e asaj treve, me dialektet anësore të Labërisë e të Çamërisë e me të folët e ishujve gjuhësorë t'Italisë autori ynë bashkohet dhe në ruajtjen e kuantitetit të zanoreve të gjata të theksuara, në rasi si *krijoj* e *bani qiellë*, e *dhënë*, e *dëtinë*, *jatilli mjëk*, *i madh gjÿq*, *dÿ* e *trë herë*. Më larg se të tjerët shkon ai në zbatimin e krasit të grupit *ë + e* në *a*, në trajta si *nda rrëfëftë* «në e rrëfëftë», *muna mbë vetë* «munë e mbajë vetë». Në konsonantizëm ruhet te ky e te të tjerët autorë të vjetër të Veriut nazali palatal *nj* që sot në gegërishten ka përfunduar në *j* më shumë se në toskërishten, në fjalë si *kopështinjëvet*, *zotnja* «zonja» e *t enjëtenë* e *madhe*, e ruhet dhe dallimi i *n-j-së* me *një-në* në fjalë si *nieri*. Ruhej në gegërishten në kohë t'autorit tonë edhe *h-ja* fundore sidomos e trajtave verbale më mirë se sot, prandaj gjejmë tek ai të *pämprehuna*, *rrena* e *çpiha*, *qi bukur i di*, e *j sheh*, e *j njeh*, krahas me më të rejat i *rref* e *j shân*, *me lëfunë* etj. Nga grupet konsonantike janë ruajtur si kudo në gegërishten e vjetër *mb*, *nd* e *ngj*, në rasi si *tue u shqimbunë* e *tue u harruom*, *Bendera* për malësinë e *Benës*, *ungjill*. Gjejmë të ruajtur te ai edhe grupet e lashta *nt* e *nk* në *as ja kã anta* (për *anda*), *të lintatë*, *kankë* si te Buzuku, te shkrintarët arbëreshë E. Santori e Rada të Kalabrisë *këntkë*; poashtu dhe grupin *fsh* si në të mëndafshhtë, sot gegërisht *mëndash*, e grupin *shq* si në *shqise*, në gegërishten e sotme *shise*. Nuk çfa-

1. Te M. Roques, Recherches sur les anciens textes albanais 35.

qen më në shkrimet e Budit grupet *kl* e *gl* që ka Buzuku (*klishtë, gluhë*) bashkë me çamërishten e me diasporën shqiptare t'Italisë, të Greqisë, të Mandricës në Bullgari e t'Ukrainës; ruhet vetëm grupi *lk*, si në *bulk* e në *bulqitë* «të lashtat në arë», po jo më te *ulk*, për të cilën fjalë përdor trajtën *uk*.

Ndër format gramatikore, një inovacion mund të themi i gjithmbarshëm i gjuhës i periodës paraletrare është përdorimi i nyjës së parme në emra etnike e në hagjionime, si në *Prifti latinë* e *j Arbëneshë, I shën Pali, T shën Gjonit*. Po një tipar arkaik është mungesa kryekrejet e një nyje të tillë pas një emri të shquar në gjindore a dhanore, në rasi të tilla si e *gjenisë tyne, Mjeshterit pëllasit*. Në kohë të autorit tonë përdorimi i neutrit ka qenë më i gjallë, prandaj gjejmë te ai ndër të tjera *ndë gjj tat, veshhtë* pranë mashkullores *veshnë, emënitë, anëtë* «ena», bile edhe *damtë*, po përgjithësisht më pak neutra se te Buzuku. E shpeshhtë është gjindorja e dhanorja e vjetër më *-et* e shumësit si te *dyeret, pleqet, kallëzorja* e tipit *rrypne e këpuçesë*, rrjedhorja shumë për *gjith anëshit*, te mbiemri atributiv koncinniteti në rasi si *godëshit mā ncë mbrapëdashit, anëmiqet mive*. Disa mbiemra të këta autorë, ashtu si edhe sot nëpër dialekte konservative brenda e jashtë Shqipërisë, na çfaqen me një trajtë më të vjetër, të pazgjeruar me prapashtesë mbiemërore: e *djathë* për e *djathtë, i lë* për *i lehtë, e pakë* për e *pakët, e shuma* për e *shumta* e të tjera si këto. I të gjithë këtyre autorëve si dhe i kolonivet arbëreshe është përemri vetor *u* për të sotmen *unë*, pronorët *yj* për «juaj», *tāj* për «tuaj» e *sāj* për «suaj», te Budi p.sh. në *ngushullimi yj, jetënë tāj, anëmiqtë e dashkëqitë tāj, i prunjëti vëllai i zotënisë sāj*; pronori i dhanores *barkut tyt* «barkut tënd»; i Buzukut e shpeshherë edhe i Budit është dhe përdorimi i të njëjtave trajta të pronorit për mashkulloren e femëroren, te Budi p.sh. *fjalëtë e mī, ndër duor të tū, gjymtyrëtë tonë*, pranë *kambëtë tona, vashasit e tua*. I këtyre autorëve, i çamërishtes e i shqipes së Greqisë është dëftori *aj* në vend të *ai*<sup>1</sup>. Veçanërisht i Budit është përemri vetor *tee* për *teje*. Nga përemrat lidhorë hyn këtu shumësi të *sijtë* «të cilët» fem. të *sijatë*, nga indefinitët *kānaj* «kënd», nga vetvetorët *vetiu* e *fëmijsë* «vetvetes e fëmijës». Nga sistemi verbal janë tipare konservimi te autori ynë ndër të tjera prezenti pa mbaresë i dëftores *blë* «blej; blen», *dro* «dron», *mbānë* «mbajnë», prezentet e aoristet e pazgjeruara me *-te* si *vë* «vete» e *vo* «vote, vate» dhe aoristet sigmatike si *ershë* «erdha», urdhëroret *mos druo* e *mos randij* «mos u rëndoni», pjesoret më *-në* e më *-të përzienë, më të panë, të hinëtë; ngritë e thātë e veshkëtë*. Me gjuhën e Buzukut më njerën, me ligjërimet e Labërisë e të Çamërisë më tjetrën anë piqet Budi te prezentet e zgjeruara me *-te*, të tipit *kate* «ka» e *s'venëte* «nuk venë», *vonëte* «vanë». Me ruajtjen e *nj-së* të pazbutur në *j* kanë lidhje trajtat verbale të kohëve e mënyrave të ndryshme, si ndër të tjera prezentet *dëshëronj, sosnjëmë, nçelnjënë, vinjënë, të mpsonjë, të shkruonjë* (Bardhi *le të shkronjë*), imperfektet *epnjinë, të hijnjinë* etj. Në imperfektet, krahas me format e vjetra të pazgjeruara, si *bij, dij, flit, njif, vish*, na çfaqen dhe të rejat më *-te* në veten e tretë të njëjësit, si *bante, dëshëronte, t'ishte, mësonte, rrëfente*, të cilat kanë fituar pastaj në gjuhën e shkrimit. Nuk mungojnë as te ky autor imperfektet «lindore» me *-ke* në të tretën e njëjësit, që buron nga një formë e *kam*, si *lypke, kthyeke*. Inovacion i një periode të caktuar mund të themi të mbarë shqipes janë prezentet e zgjeruara të tipit *sosënj*,

1) Për shqipen e Greqisë (Kulluri-Salamina) khs. tani Cl. Haebler, *Grammatik der albanischen Mundart von Salamis* (1965) 92.

heshtën, lutën, mundën, ndritën, te Buzuku *kuorën* «ai korr», te Bardhi *lefën*, te Bogdani *shkrepën*, *zbardhën*, në Greqi *gjeshënj*, në Itali *qeshënj*, të *ngroghën* etj. Si verb ndihmës, përveç së zakonshmes *kam*, te autori ynë si dhe te të tjerët, në intransitivet e në verbet e gjendjes çfaqet dendur dhe *jam*, si në *ashtë rām*, *ishnje qenë*, *të jëtë dalë*, *t'i jëtë pëlqyem*. Në urdhëroren na dalin dhe format e kontraktuara, si *ndëgjë* «dëgjoje», *dërgë*, *forcë*, *mbë*, Në dëshirore dhe trajta më të rralla si *të ruojtitë*, te Lekë Matranga në Siqeli *shejtëruatë* «sia santificato». Nuk mungojnë dhe lidhoret e vjetra pa të, si *mos lanë*, të cilat janë ndërkaq më të shpeshta te Bogdani e sidomos te Buzuku. Të burimit gegë «lindor», si imperfektet e tipit *lypke*, sidomos të shpeshta te Buzuku e te Bogdani janë lidhoret e trajtës së dëftores, te Budi p.sh. *del* «të dalë», *të mer* «të marrë». Në mesore-pësoren, pranë trajtave më të reja më *-h-*, si *bahetë*, *mbahenë*, na paraqiten dhe ato më të lashtat më *-n-*, si *lëshonetë*, *ushqenenë*, *mundonej*, e ngandonjëherë janë përdorur krah për krah që të dyja, si (SC 230) *nçtonenë e shumohenë*. Nga sintaksa e verbit meritojnë një vemendje të veçantë disa ndërtime me dhanore në vend të — kryesisht — kallëzores së sotme, te Budi p.sh. *s ndëgojnë njanin tjetërit*, *me i rrëm* «me e rrejtë», *t'i mpiqenë e ta ndjekënë*, *kësaj kafshë me j pruojtunë* me kuptimin «i dal përpara, ruhem prej saj», te Buzuku *përoni së vejësë* «defendite viduam». Mbiemrat e ndajfoljet homomorfe dallohen në mes të tyre jo vetëm me anë të nyjës së parme, po dhe me mungesën e *-ë-së* fundore te ndajfolja e mënyrës, në rasat kur e ka mbiemri, te Budi *fshtir*, *lir*, *shkret* përkundrejt *i fshtirë*, *i lirë*, *i shkretë*. Autori ynë përdor dhe *mbi* si ndajfolje, në rasi si *ke të dërejtëtë mbi*. Ai është i vetmi që ka dhe *qyetë* «aq» për të shënuar një shumicë qeniesh ose sendesh, si p.sh. në *qyetë herë*. Të përbashkët me shkrimtarët e tjerë të Veriut ka ai parafjalën *q* nga një *en*, në rasi si *q gjithë fajeshit e mkateshit*. Në fjalëformim ka ndonjë prapashetë interesante, si *-im* me funksion mbiemëror, në *gozhdat hekurime* (DC 258), e cila na del si *i hekurimtë* dhe në arbërishten e Siqelisë (G. Dara) e të Greqisë.

Për historinë sidomos të gjuhës letrare e të fjalorit të saj një rëndësi të veçantë ka leksiku i Budit. Te ky e të tjerët shkrimtarët tanë të vjetrit mund të ndiqet e të shihet se kur çfaqen për herë të parë fjalët që përbëjnë pasurinë e visarit leksikor të shqipes, sidomos ato që përfaqësojnë fjalorin e sferës kulturore. Pa hyrë në hollësi, le të përmendim se nga të vjetrit vetëm Budit ka fjalën *kuor kori* me kuptimin «herë, kohë, rend, zakon, masë», në shprehje të tilla si *e ndë goditë kori qi ta mbërinjë e as e madhe as e vogëlë*, *po ndë kuort*, *sā desh ligja*; prej andej dhe mbiemrat *i përkormë* «që ka masë, temperans» e *i pākorë* «që s'ka masë, intemperans» te të gjithë këta autorë si edhe sot e gjithë ditën në gjuhën popullore. Tek ai na dalin për herë të parë në shkrim të shqipes ndër të tjera *i arësyeshëm*, *argëtuom*, *argëtuoshim*, *asgjāmangu*, *barna*, *bulmët*, *cof*, *çkallëmuom*, *çkatërronetë*, *damëtonj*, *dashëkeq*, *dies*, *djemën*, *dridhmë*, *efsh*, *i epër*, *fantazi*, *jaruom*, *ferratë* «shkop», *fjalëkëq*, *fshanëtimë*, *fllonj*, *furi*, *gërdhuzë*, *gojëplotë*, *gratënë*, *grykësia*, *gjukatë*, *gjymtyrë*, *hullë*, *huo* «hoje», *irënuom*, *jerm*, *kallamār*, *kaptonj*, *kënaqe*, *kërcuni*, *kërrabullor*, *kolegj*, *krepull*, *kundrështur*, *kundrështi*, *kurmzuom*, *letërorëtë*, *lëngim*, *ligjëronj*, *madhështuor*, *malcuom*, *mallënjim*, *mallënjyem*, *i mangët*, *mëryem*, *mirëfilli*, *moshtrë*, *mpose*, *mundështonj*, *ndaqa*, *ndish*, *i ndrithshim*, *ngërmonj*, *ngiat*, *nkrijuosi*, *pakmos*, *të pākujdestë*, *i pāudhë*, *peranduo*, *përbehem*, *i përbrendshëm*, *përbuzunë*, *përgjonj*, *përmend*, *përmend* «përmendësh», *përshtëndet*, *përtesa*, *përtësëllë*, *i përvnershim*, *i përzjarmshim*, *pikë*, *i*

*pushtuoshim, qëlluom, i remtë, resë, resh, risht, rubrikë, rraha shm., rremb, rreth, rreze, rrjesht, sqimë, sqimatâr, shembëll, shëmtonj, shigullonj, shkak, shkëlqenj, shortëti, shqyrëtonë, shtampatarëvet, tmër, truoll, thithëlopë, i thjeshtë, thuose, urdhënim, vajme, vobëzi, zell, zgerbe, zyrrë, zhyem.* Ka pastaj disa fjalë të rralla e pjesërisht dhe të dyshimta, si ndë çokazë, i lacëmuom, latrizuom, u linxuo, me magulluom, manjënuom, posonjë, vjginikë me i vjginikuom e ndonjë tjetër. Pjesërisht të përbashkëta me të tjerët shkrimtarë të moçëm të Veriut janë nga kjo sferë e leksikut ndër të tjera fjalët *arbën, arësye, arëtonj, artikull, bruo* «bariu, prifti», *dergjem, detyrë, dëlirë, i ditëshim, dhunë, dhunëti, ende* «edhe», *endja* «lulja», *frati-a, gazëmend, gjakësia, gjukatës, gjyq, kallëzonj, kapitull, këndëll, kujdës, kurt, kusht, kushtim, letërë, ligj, madhësi, marmur, mbërrinj, mundim, më ndjetë* «më duket», *ngatërroinj, ngënjim, i pëçmuom, pagëtyrë, pajtonj, pëllas-i, i përditshim, përtërinj, pushtonj, qell dhunë, rangë, regj, regjëni, rrasë, sülferë, shkëlbozë, shkretëti, shkruos, shoqëni, shpëresë, shqisë, vdjerrë, vëpërë, vëllazëni.* Kërkime më të thelluara mund të tregojnë një ditë se nga këto e nga të tjerat elemente të leksikut abstraktmendtor cilat janë krijime letrarësh, cilat janë fjalë të marra prej gurrave të gjalla të gjuhës së popullit dhe cilat rrjedhoja të mëtejme të fjalëve popullore. Një grup më vete përbën brenda këtij leksiku kulturor si një nga pjesët më të lashta të tij terminologjia fetare, me fjalë si *i amëshuom, bakmi, bëkonj, besonj, e diela e bardhë, dita e gjyqit* «Dies irae», *ditë e shënuome, faj fajëtorë, famullia, fë, i fëshim, ferr, të frujtuoshime, himn, hîr, idhull, iltër, inkónzëzë, jere mi, kalçind, këreshmë, kërshtëndelle, kërshtenimi, kishë, korp, krezm, kryq, kumëtrinë, kungonj, letanî, i lumi e lûmeja, mallëkuos, meshë, mkat murtâr, ndëjenj, ndëjesë, ngjënonj ngjënim, nktheva* «përktheva», *ntrúositë, pagëzonj, parriz, pëndohem, pëndesë, të rëfyemitë, ujët e bëkuom, ungjill, upeshkup, uratë.* Kjo sferë leksikore përbëhet në pjesën më të madhe nga elemente latine e (më vonë) romane (italiane), për një pjesë nga fjalë greke, për një pjesë nga fjalë vendi të përdorura qëmoti. Ajo që ndërkaq bie në sy këtu, është mungesa kryekrejet e elementit sllav në këtë pjesë të leksikut: gjë që tregon se në kohën e dyndjeve të para sllave gjuha kishtare e shqipes ishte formuar, një rrethanë me rëndësi si për gjuhësinë si për historinë shqiptare. — Për historinë e shqipes e të fjalorit të saj një rëndësi më vete në këtë mes ka kjo, që nga fjalët e ditura të këtij fjalori ka disa, të cilat tek autorët e vjetër na dalin me një trajtë ose një domethënie ndryshe nga sot. Gjejmë kështu të Budi, ashtu si të Buzuku e të shumica e të tjerëve, si dhe nëpër disa dialekte të sotme, *pellëg* për *pellg, fëjenj* për «bëj faj» e «fyej», (*dy*) *fijesh* për *dyfish, këndellem* për *knellem, kiem* për *kem-i, vistâr* për *visar*, të Budi edhe *fushqinë* për *fuzhnje, mëndryem* për *ndym, psalikim* për *salikim, munëshitûr*, një formë që sot ruhet vetëm në toponimi. Për kuptimet do të shënojmë se autori ynë fjalën *buzë* e përdor dhe për «cep, anë», në shprehjen *buza e krahut; e lagje* e ka për «palë, grup, parti»; bashkë me të tjerë *lenj* e ka dhe me kuptim transitiv «pjell» (për njerëz) e *lehem* për «lind», *perëndia* dhe me kuptim «mbretëria», *artë perëndia jote* «veniat regnum tuum», Bardhi *perëndi* «Caesar», *Perëndesha* «Imperatrix», Bogdani *G. Cezarë Perëndin e Romësë* «G. Cesare Imperator Romano», *katër perëndija* «quattro monarchie»; e verbën *perze*, sot «dëboj, ndjek», këta autorë e kanë për «pranoj, pres». Në lidhje me elementin turk të shqipes është vendi të shënohet këtu që në ligjërimet arbëreshe t'Italisë më njerën e të shkrimtarët e tjerë të Veriut më tjetrën anë

na ruhet shtresa më e vjetër e këtij elementi, e cila paraqet interes për mbarë ballkanistikën si dhe vetë për turkologjinë. Te Budi ndërkaq ky element është disi i pakë në krahasim me kohën kur janë shkruar veprat e tij. Kjo gjan të lidhet me qëndrimin shpirtëror të autorit tonë ndaj botës osmane e me prirjen për të përdorur sa më pak fjalë turke në shkrimet e tij.

Karakteri i përgjithshëm i gjuhës së Budit na paraqitet me aspekte të ndryshme sipas anëve nga të cilat ta vështrojmë. Nga pikëpamja e tipareve të lashta gjuha e tij na çfaqet më pak arkaike nga gjuha e Buzukut, me gjithë se dy autorët nuk i ndajnë më se dy breza. Kjo gjë për mendimin tonë ka më fort arsye të gjeografisë dialektore sesa të kronologjisë. Për autorin e Mesharit nuk ka të dhëna konkrete për vendin nga rridhte, po ka indice që flasin për një dialekt verior periferik, i cili si i tillë ka qenë më konservativ se dialektet qendrore të gegërishtes s'asaj kohe. Baza e gjuhës së Budit përkundrazi, në pajtim me burimin e tij prej krahinës së Matit, është një gegërishte më pak veriake, më e mesme, më qendrore. Prej gegërishtes qendrore kanë dalë pas gjase gjatë periudhës turke të shqipes inovacionet fonetike si monoftongimi i diftongjeve e i grupeve vokalice dhe asimilimet e grupeve konsonantike *mb*, *nd*, *ng* e *ngj*, të cilat e kanë larguar këtë dialekt nga faza e vjetër e tij e njëkohësisht dhe nga toskërishtja. Dihet se këto lloj inovacione, këto thjeshtime të sistemit vokalik e konsonantik, për një pjesë të madhe nuk kanë arritur të depërtojnë as edhe sot në gegërishten periferike, as në krahun veriperëndimor as në krahun lindor. Dhe është karakteristike në këtë mes, që në sistemin fonologjik të gegërishtes lindore krahas me ruajtjen krahinore të grupevet konsonantike sapo të përmendura shkon kompensimi i monoftongimit të diftongjeve të vjetra me anë të segmentizimit të vokaleve të gjata, i cili solli diftongimet sekundare të asaj treve. Në kohë të autorit tonë ndërkaq inovacionet fonetike në fjalë mezi kishin nisur të çfaqeshin e të përhapeshin në trevat qendrore të Gegërisë.

Me ç'u tha këtu për dialektet e gegërishtes nuk do menduar se këta autorë kanë shkruar në dialekt. Karakteri i gjuhës së tyre nga kjo anë paraqitet më kompleks dhe meriton të gjurmohet më hollë. Dialekti regjional prej të cilit rrjedhin përbën bazën, nga ku ata u ngritën në një gjuhë shkrimi mbidialektore. Kjo është edhe e natyrshme për ta, sepse ata janë të vetëdijshëm që shkrimet e tyre janë të caktuara për krahina më të hapëta e për shtresa më të gjera të popullit. Kështu gjuha e tyre vërtet ruan disa tipare të një dialekti të veçantë dhe me këtë kallëzon proveniencën krahinore të çdo autori, po mbetet prapë një farë koineje e shkrimit, një gjuhë e kuptueshme për të gjithë. Këtë karakter të gjuhës letrare e ka determinuar dhe qëndrimi i këtyre shkrimtarëve në krahina të tjera e lidhur me këtë dhe njohja e të tjerave dialekte të shqipes. Kështu Bogdani, si një bir i Shqipërisë verilindore, ruan vërtet ndonjë veçori gjuhësore të atij krahu, si *bani me bam një shembëlltyrë fort mbë gasë të t'bir* «fece fare nu ritratto molto simile al suo figliuolo», po duke jetuar për më se njëzet vjet në anët e Shkodrës, ja përshtati ligjërimin e vet një njësie dialektore më të madhe, sikundër na thotë ai vetë në hyrjen (Të primitë) e veprës së tij: «përse tue kjanë unë prej Guri ndë Hast... m'anshtë dashunë me djersë të mëdha shumë fjalë me ndërequnë ndë dhë të Shkodërsë». Edhe Budi, i cili kaloi një pjesë të jetës së tij në anët e Kosovës e të Maqedonisë, ka synuar sigurisht në një gjuhë që t'i kalonte caqet e ngushta dialektore. Në këtë vështrim na shprehet ai vetë,

në letrën që i bën Kardinal Gozzadinos, ku shkruan ndër të tjera se si vikar i përgjithshëm i Serbisë «nel qual essercitio per spaccio di dicisette anni per quanto mi e stato possibile non ho mancato ad ogni diligenza, aiutare et confortare quei populi, et i medesimi Sacerdoti con essempij spirituali, scrivendo sempre libri spirituali alla lor lingua tanto a quelli della Servia, quanto a quelli dell'Albania come hoggidi si vede per tutti quei paesi». Këtu pra pas mendimit tonë është fjala jo për libra serbisht e shqip, po për libra shqip shkruar për klerin katolik shqiptar, dhe të Serbisë dhe të Shqipërisë. Shohim kështu se karakteri i gjuhës së shkrimit zhvillohet në drejtim të një zgjerimi, njëkohësisht duke lënë mënjanë vazhdimisht trajtat dialektore tepër të veçanta. Jemi larg tanimë nga gjendja në shekullin e XV-të, kur në Formulën e Pagëzimit të vitit 1462 gjegjë më të përdorur formën *shpërtit* të ligjëritit të Matit.

Nga pikëpamja e ndërtimit sintaktik dhe e stilit proza e Budit paraqitet prolixë, me periudha të gjata, me fjali të ngjeshura me dubleta sinonimesh. Ky është stili i kohës, po me gjith'atë krahasimit filologjik i bie barra të diktojë gjer ku autori ynë ndjek gjedhen e teksteve nga përktheu, e gjer ku rreh rrugën e vet. Edhe duke qenë në pjesën më të madhe përkthime, shkrimet e tij janë ngjeshur mirë me brumin e gjuhës amtare. Te Pasëqyra e t'Rëfyemit, të cilën e zbuloi sëpari Faik Konitza në Bibliotekën Mazarine të Parisit<sup>2</sup>, gjejmë mjaft shprehje të marra nga të folët popullor. Khs. ndër të tjera *mā s kam s̄y e faqe me j dalë përpara; u qet kapistërrë n qafë . . . e j hjek mbas vetëhej; tue paguom këpucë* (për «shpërblim»); *e përsëri nkthjem mbë ta porsiqeni mbë të vjellët; thëngjilli i mbuluom; me shtim laknë n qafë; ashtë mā harruom e qitunë ndenë kambë; sikur uku ndenë lëkurë të delesë; kush shet kalënë duhetë me j dhanë ende kapistërrë* (f. 7, 12, 123, 139, 220, 294, 303, 339 385, 386). Krijimi i Budit gjan të jetë përkundrazi emërtimi i universitet me *rrethi i shekullit*, një shprehje që të kujton gjerm. *Weltkreis*, ndërsa sot përdoren *rruzullimi* i Bogdanit dhe *gjithësia* e N. Frashërit. Te Pasëqyra e te Ritualit Romak, zbulimin e të cilit ja detyrojmë Mario Roques-ut, autori me rastin e trajtimit të besimeve të kota që duan lëftuar, na shtron përpara disa doke e zakone dhe disa figura të mitologjisë popullore. Kështu ai si më i vjetri burim i folklorit shqiptar zë kryet e vendit në këtë fushë studimesh dhe një vend me rëndësi dhe për folklorin ballkanik të krahasuar.

Karakteri i përgjithshëm i gjuhës ka lidhje m'anë tjetër edhe me çështjen e traditës së shkrimit në Shqipëri, dhe të lashtësisë së saj. Pa mundur këtu të hyjmë më thellë as në këtë çështje, do të vëmë në pah se gjuha e kësaj literature të vjetër, me gjithë dobësitë e padyshimta që ka, paraqitet me një formë të zhvilluar në një mënyrë që është aftë për shkrime të një karakteri letrar. Ortografinë e përdorur në këto shkrime, me gjithë lëkundjet e inkonsekuencat që ka, e gjejmë mjaft të stabilizuar, rregullësitë mbizotërojnë mirë mbi parregullësitë. Terminologjia fetare paraqitet e tillë që shihet se është ngulitur prej kohësh. Këto rrethana së bashku paravendojnë një përdorim më të gjatë, d.m.th. një traditë të mëparme të shkrimit. Dihet që arqipeshkvi i Tivarit Guillelmus

2) Mario Roques ka mundur të zbulojë dhe dy ekzemplarë të kësaj vepre në Bibliotekën Vatikane, duke i çuar kështu ekzemplarët e ditur në tre. Këtyre do shtuar tani dhe një i katërt ekzemplar. Sikundër më kumton z. prof. Gunnar Svane i Universitetit të Kopenhagenit me letrën e tij të datës 13.XII.1964, kjo vepër e Budit gjindet dhe në Bibliotekën Mbretërore të kryeqytetit të Danimarkës.

Adae, i quajtur dhe Brocardus, thotë për Shqiptarët që kanë një gjuhë më vete dhe që në përdorim e në gjithë librat e tyre kanë letrat latine. Fakti që në shkrimet e mbishkrimet e vjetra të Arbëreshve t'Italisë dalin dy mënyra shkrimi që janë të përbashkëta me ato të akteve të moçme të Veriut tonë, zanoret dyfishe për të shënuar gjatësinë dhe *x* për sibilantin *sh*, sikundër e kemi shprehur para disa vjetve, më fort se për një koincidençë të rastit dëshmon për një traditë shkrimi të përbashkët, të pakën pjesërisht, për krahinat veriore e jugore të vendit që në kohën para shpërnguljes shqiptare për në Itali. Pra mund të thuhet që shkrimtarët e hershëm janë mbështetur në një traditë të mëparme. Duke u nisur nga fakti që shumica e literaturave t'Europës kanë nisur me shkrime të karakterit fetar, një gjë të tillë mund të mendojmë dhe për Shqipëri, me gjithë se nuk përjashtohet a priori mundësia e ekzistencës së shkrimeve të lashta me karakter laik, si letra, kronika etj. Shkrimet e para fetare duhet të kenë qenë copa me përmasa të kufizuara, si lutje e urata, besojma, këngë kishtarë, pjesë të ritualit që përdroreshin me raste të ndryshme si në pagëzim, në kurorë e në të kremte të ndryshme, copa ungjijsh, katekizma të vogla etj. Edhe shkalla e kulturës së popullit në Shqipërinë paraturke, prania dhe veprimtaria e disa urdhërave fetare si benediktinët, dominikanët e françeskanët, do të dëshmonte më fort në të mirë të një tradite paraturke të shkrimit sesa kundra saj.

Çështja e traditës përveç se për literaturën është me rëndësi dhe për historinë shqiptare. Ajo lidhet me çështjen se që kur mund të flitet për praninë e elementit shqiptar në bregdet t'Adriatikut. Mbi dëshminë e disa dokumenteve historike një lagje historianësh e gjuhëtarësh të shquar mendojnë se disa nga qytetet kryesore të bregdetit gjer aty nga shekulli i XIII-XIV-të kanë qenë banuar prej «latinësh», pasardhës të provincialëve romakë e të afër me elementin roman të bregdetit të Dalmacisë. Këtë çështje që përbën një problem shkencor për etnografinë e për historinë, ne e çekim këtu jo për ta marrë në analizë, po për të lidhur me të katër pyetjet, dy të karakterit gjuhësor e dy të karakterit historik: Si pajtohet me këtë communis opinio thujasë aksiomatike fakti që toponimia e re e kësaj treve rrjedh nga e vjetra vetëm nëpërmes të ligjeve fonetike të shqipes? Ku janë gjurmët gjuhësore të kësaj popullësie «latine» në gjuhën shqipe, siç janë ato të dalmatishtes në serbo-kroatishten? Kur elementi shqiptar nguli në këto anë vetëm aty nga shekulli i XIV-të, si bëhet që pas një shekulli qe në gjendje të bënte një rezistencë në shkallë nacionale, e cila tërhoqi vemendjen e asaj kohe? E si spjegohet që pas dy shekujsh bash në këto anë na çfaqet një literaturë në gjuhë të vendit? Këto e disa të tjera rrethana e bëjnë të nevojshme që kjo çështje të rimerret në një shqyrtim objektiv nga ana e historisë dhe e gjuhësisë. Përfundimet ku mund të arrihet besojmë se nuk kanë për të qenë pa rëndësi në punën e hetimit të lidhjeve historike të elementit shqiptar me botën romane, me botën bizantine e me popullësitë sllave në trevat perëndimore të Gadishullit të Ballkanit.

Me interes të veçantë është mënyra çështja nëse veprat e shkrimtarëve të vjetër, duke përfshirë ndër ta edhe Budin, kanë edhe vlerë letrare, apo vetëm një vlerë gjuhësore. Për të dhënë një gjykim në këtë mes besojmë se nuk mungojnë kriteret objektive shkencore. Në këto vepra vihet re përpjekja e autorëve të tyre për një shprehje gjuhësore estetike të bukur. Vihet re gjithashtu se këta ja arrijnë këtë qëllim në një masë të gjerë. Veçanërisht te Budi kjo çështje merr një rëndësi të veçantë. Poeti arbëresh Zef Skirroi nga Hora e t'Arbëreshvet të Siqelisë

që më 1918 ka vënë në dukje se Budi është autori i më se 3000 vargjeve dhe se këtyre vargjeve nuk u mungon vise-vise dhe frymëzimi poetik. Para Budit i pari autor i Arbëreshvet t'Italisë Lekë Matranga pat shkruar më 1592 një stancë (oktavë) të ndërtuar pas rregullave të poetikës italiane. Nuk është vënë re që përpjekjen e parë — me gjithë se të vogël — për një ndërtim poetik në gjuhë shqipe e gjejmë te Buzuku (folio XII verso, shtylla e parë), në shqipërimin e këngës fetare latine «Ave maris stella, Dei Mater alma», shqip *Tÿ të n'falemi, o uilli i detit, e Amë e denjë e Tinëzot*. Te Doktrina e Budit gjinden 721 strofa katër vargjesh, pra gjithsejt 2884 vargje. Aty prin një parafrazë e bukur e «Dies irae»; vijjnë pastaj një tufë vjersha që na paraqesin skena nga të Dhjatës së vjetër dhe të së resë. Në fund të Ritualit autori na jep një shqipërim të këngës «Laudans inuocabo Dominum» me dyzet vargje dyshe ose tetëdhjetë vargje. Te Pasëqyra ka shqipërimin e «In honorem Beatae Mariae Virginis» me pesë, të «Ad Sanctissimum D.N. Gregorium XV» me tetë e të «Supplicationes, et gratiarum actio ad Deum Opt. Max.» me njëzetetë strofa katërshe, pra gjithqish 164 vargje. Me këto poezi prej gjithsejt 3128 vargjesh Pjetër Budi mbetet i pari poet i literaturës shqiptare. Shumica e vjershave të tij me frymëzimin mesatar të tyren paraqiten si kronika në vargje, po ka dhe pjesë ku vezullon një shkëndijë poetike e vërtetë. Vargjet janë oktonarë. Në to, si ka vënë re sëpari Henrik Lacaj, lot rol dhe gjatësia e silabës, duke u numëruar për dy silaba. Khs. të tilla vargje si *I madh gjÿq, e mëni Të vinjë për mkate tonë ose Pā tmër pā frikë, a Sikūr i pret me shpatë*. Vargjet e autorit tonë na kujtojnë vargjet e poemave të Naimit. Ka të gjarë që poeti i Frashërit të jetë frymëzuar te vjershat e poetit të vjetër të Veriut. Shohim kështu që, ashtu si çdo lëvizje mendore, edhe poezia jonë e shekullit të XIX-të nuk ka lindur nga asfarja, po ka marrë ushqim dhe në rrënjë të ndryshme. Ajo mbështetet më një anë në metrikën popullore, e njëkohësisht m'anë tjetër dhe në një traditë letrare më të moçme.

## R é s u m é

### PJETËR BUDI ET SA LANGUE

*Pjetër Budi occupe une place importante dans le mouvement littéraire albanais du XVI-ème et XVII-ème siècle, débutant par Gjon Buzuku (1555) et continué, outre Budi lui-même, par F. Bardhi (F. Blanchus), P. Bogdani, Gj. N. Kazazi et d'autres. Des divers facteurs d'ordre historique, facteurs externes et internes, ont contribué à la formation de ce mouvement, lequel marque les débuts d'une langue littéraire et d'une poésie composée en cette langue. Il y a eu d'une part l'impulsion donnée par la Contre-Réforme à la rédaction de livres ecclésiastique dans les langues nationales. D'autres part, dans les conditions spécifiques de l'Albanie, l'occupation turque et l'islamisation progressive de vastes régions du pays qui en dérivait, a fait naître dans des esprits comme Pjetër Budi l'aspiration à la conservation de l'ancienne religion aussi bien que de la conscience et de la langue nationale, et par cela même la volonté d'écrire des livres qui pourraient servir à ce double but.*

*La langue de Budi présente les traits caractéristiques d'un dialecte*

guègue de son temps. Dans ses caractères généraux, cette langue n'avait encore atteint le degré d'évolution qui devait plus tard éloigner ce dialecte du tosque et en même temps du type commun de la langue. Ainsi donc, en matière de phonétique, on trouve maintenues, entre autres, la quantité des voyelles longues, les diphthongues et les groupes vocaliques, et l'è atone dans une mesure plus large que dans le guègue moderne. On observe du même une meilleure conservation des groupes consonantiques, tels que mb, nd, ngj, shq, assimilés ensuite dans ces parlars. Des formes grammaticales, l'emploi de l'article prépositif est en général plus limité que dans la langue actuelle, phénomène important pour l'histoire de cette catégorie. Dans les traits conservatifs du domaine des noms sont à ranger, entre autres, l'emploi plus large du neutre et des anciennes formes du système des cas, et en ce qui est de l'adjectif, les formes simples au lieu de celles élargies par des suffixes, et la congruence dans l'emploi de l'attribut, type anëmiqet mive «à mes ennemis». Des traits archaïques persistent du même dans le champ du pronom personnel et possessif. Le même vaut pour le système verbal, notamment en ce qui est des diverses formes du présent, de l'imparfait et de l'aoriste, actifs et passifs, de celles du subjonctif, de l'optatif et du participe. A côté de ces phénomènes de conservation on remarque telle innovation commune aux divers parlars, comme le présent élargi en morphème nasal, type lutën «il prie», ou le présent élargi en -te, comme kate «il a». La syntaxe du verbe présente aussi des cas intéressants. Même chose vaut pour les adverbes et les prépositions, comme aussi pour quelques éléments de la formation des mots.

D'une importance spéciale pour l'histoire de la langue littéraire est le vocabulaire de cet auteur, principalement en ce qui concerne les éléments appartenant à la sphère abstraite de la pensée et aux termes de culture. Il importe de noter à ce propos qu'un bon nombre de mots qui ont trait à cette sphère apparaissent pour la première fois chez cet auteur. Un groupe à soi forme dans ce cadre le vocabulaire religieux, où mérite d'être noté le manque total de termes d'origine slave, fait important aussi pour l'histoire de l'église albanaise et de son vocabulaire liturgique. Parmi les autres mots des anciens textes il y en a de tels qui présentent des formes, et d'autres qui présentent des acceptions diverses de celles qui valent pour l'état actuel de la langue.

Au point de vue de l'histoire de l'albanais et des ses dialectes, Pjetër Budi apparaît moins archaïque que Gjon Buzuku, antérieur à lui seulement de deux générations. Cela tient à notre avis au caractère plus marginal de la langue de ce dernier et au plus central de celle de notre auteur, et au fait que les innovations avérées dans le domaine du guègue ont pris leur point de départ des régions centrales de cette zone dialectale. On peut dire pourtant en ligne générale que Budi, tout aussi bien que les autres représentants de l'ancienne littérature albanaise, même en maintenant les traits spécifiques de son propre dialecte, en vue de la destination de ses livres, s'est appliqué à écrire en une espèce de koiné, dans une langue aux traits plus communs et accessible à un cercle plus large de lecteurs. Il y a là un fait digne de considération pour quiconque entreprend à étudier l'histoire de la formation de l'albanais comme langue littéraire. Du point de vue de l'écrivain, la prose de Budi, conformément au style de son temps, se présente d'une allure assez proluxe, et pleine de doublets de synonymes. Un mérite spécial va cependant à l'auteur d'avoir employé dans une acception nouvelle, en vue de les fixer comme

termes, des mots existant auparavant, et d'avoir introduit dans ses phrases pas mal d'expressions populaires. Cela vaut surtout pour son oeuvre *Speculum Confessionis* (*Pasëqyra e t'Rëfyemit*), dont l'exemplaire de la Bibliothèque Mazarine de Paris fut découvert jadis par F. Konitz et deux autres exemplaires ont été trouvés ensuite par M. Roques dans la Bibliothèque Vaticana, et dont existe un quatrième exemplaire à la Bibliothèque Royale de Copenhague, à la connaissance duquel nous sommes redevables à Mr. le Prof. G. Svane.

Les anciens textes sont importants aussi pour la question de l'origine et la chronologie de l'albanais comme langue écrite. La notice de l'archevêque d'Antivari *Guillelmus Adae* (Maître Brocardus, Brochard) sur l'existence de livres écrits en albanais vers l'année 1332, trouve une confirmation dans la langue de ces textes, laquelle apparaît — malgré ses défauts — dans une forme assez établie, ce qui présuppose une tradition littéraire. Le fait que quelques éléments d'orthographe, tels que les voyelles doubles à valeur de voyelles longues et x à valeur de la sifflante sh, sont communs aux écritures de l'Albanie du Nord et des colonies albanaises d'Italie, indique en outre une tradition existant jadis dans des régions de l'Albanie septentrionale et méridionale en même temps, plutôt qu'une coïncidence fortuite. Bien entendu, ces premiers essais n'auront été que de courtes pièces telles que des prières, des oraisons, des morceaux de rituel, sans exclure peut-être des petits textes de caractère profane, comme les lettres privées, des petites chroniques, etc.

A la question de la tradition littéraire se rattache le problème de l'autochtonie du peuple albanais dans ses sièges actuels. Un examen objectif et critique exige à cet effet la thèse soutenant que la présence de l'élément albanais dans le littoral de l'Adriatique est relativement tardive, que jusqu'au XIII<sup>ème</sup> et XIV<sup>ème</sup> siècle ce sont des «latini» qui ont habité dans ces parages. Le caractère de la toponymie albanaise d'une part et le nombre exigü de romanismes susceptibles de provenir d'une telle source de l'autre, militent aussi peu en faveur de cette thèse que le fait de la lutte nationale au XV<sup>ème</sup> et l'existence d'une littérature au XVI<sup>ème</sup> siècle.

A la question enfin s'il faut reconnaître à ces textes, outre leur valeur linguistique, une valeur littéraire aussi, on doit donner une réponse affirmative. Cela vaut notamment pour Pjeter Budi, auteur aussi de poésies religieuses atteignant le nombre de 3128 vers octonaires. Bien que l'inspiration de ces poésies, sur lesquelles le premier a appelé l'attention le poète italo-albanais Zef Skirò, est à considérer en général médiocre, il s'y trouvent pourtant des parties d'un vrai contenu poétique. Avant Budi c'est L. Matranga de Sicile (1592) qui a composé des vers (une stance) en albanais. Nous croyons avoir constaté cependant une première tentative poétique dans le *Missel* de Buzuku. Pour finir, nous voulons relever le fait que le poète N. Frashëri ressent à notre avis des traces de l'influence de Budi dans l'allure générale des vers de ses poèmes. Il y a là une continuation de la tradition poétique à travers les siècles.